

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

V.A.L.E. RECYCLING

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L28029301Q

NUIS/NIPT

Fshatin Gurez, afer ish-Kanalit te Acidit

Adresa

Kurbin

Albania

4706

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0684008003

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

recycling.vale@gmail.com

E-mail

Administrator Elvis Miri

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/01/24

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

+355684008003

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-93267-01-17-2024

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlore

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

17500000

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2024/02/02

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Shërbime

2024/02/02

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/27363/01172024

90524100-7

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

LIGJ Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”

VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.402, datë30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër

□

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

II.1. Në datën 18.01.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me Nr. REF-93267-01-17-2024, me objekt “Evadim i mbetjeve të rrezikshme spitalore”, me fond limit 8 17 500 000 (Shtatembedhjetë milionë e pesëqind mijë) Lek pa Tvshleke? pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 02.02.2023 nga autoriteti kontraktor “Drejtoria e Spitalit Rajonal Vlorë”.

II.2. Me datë 18.01.2023, autoriteti kontraktor ka ngarkuar në SPE dy “SHTOJCA PER MODIFIKIM” të shtojcës 6, me të njëjtën përmbajtje.

II.3. Me datë 23.01.2023, autoriteti kontraktor, ka ngarkuar në SPE dy “SHTOJCA PER MODIFIKIM” të shtojcës 7 kriteret e veçanta të kualifikimit, ku në njërin përcaktohet “Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 02/02/2024” ndërsa në tjetrën “Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: 09/02/2024 Ora:10:00”.

Brenda afatit ligjor (7 ditë nga dita e publikimit të shojcës në SPE) paraqesim këtë ankesë pranë AK-së dhe KPP-së për sa më poshtë vijon.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

1. Nga ana e autoritetit kontraktor me publikimin e kësaj procedure prokurimi janë publikuar dhe kriteret e përgjithshme të veçanta të kualifikimit, argumentimi i secilit kriter, preventivi me zërat përkatës, volumet etj.

Duke qënë një procedurë prokurimi e vecantë sic është procedura e prokurimit për shërbimin e trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore, në konstatojmë se kemi kritere të veçanta kualifikimi të cilat janë diskriminuese dhe sjellin pengim të konkurrencës së lirë duke rënë ndesh me parimet bazë të LPP-së për sa më poshtë argumentojmë.

A) Në DST nga AK është kërkuar:

SHTOJCA NR. 8

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriterete e Veçanta të Kualifikimit

“2.3.5. Operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera/perdorim, apo nepermjet cdo menyre posedimi të njohur nga ligji, impiant/e, makineritë e mëposhtme që të mundësojë trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve objekt i ketyre DST, sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 “Per

menaxhimin e integruar te mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe te VKM-se per miratimin e rregullores “Per menaxhimin e mbetjeve spitalore”, (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, si më poshtë:

- a. Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up ose zevendesues me të njëjtën metodë;
- b. Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up ose zevendesues me të njëjtën metodë;
- c. Makineri për larjen e kontenierëve cope 1 dhe makineri back up ose zevendesues të tillë (vetem ne rastin kur do te perdoren konteniere te riperdorshem);  
Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të disponojë dokumentat e mëposhtme provuese:
  - a) Dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë, huapërdorjes ose të marrjes me qera të pajisjes (ku afati i marrjes me qera/perdorimit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit të këtij objekti prokurimi);
  - b) Të jenë të pasqyruar në akt miratimet e lëshuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër;
  - c) Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerise;
  - d) Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e te dhenave konkrete per seicilen pajisje (përfshirë edhe ato back up), nepermjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST, duke përfshirë të dhënat si vijon: emërtimi i impiantit / modeli / rrymat e mbetjeve që trajton dhe/ose asgjëson / Leja dhe Licensa përkatëse ku janë të përfshirë (nga ato të paraqitura në përmbushje të kriterit 2.1.1 dhe 2.1.2 më sipër

Shënim nr.1:

KVO rezervon te drejten e verifikimit ne terren lidhur me funksionimin e proceseve te punës për secilën nga pajisjet sa me sipër.

Shënim nr.2:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet :

“Bashkë me orëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në kështu rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”. Bazuar ne Vendimin e Këshillit te Ministrave nr.798, datë 29.9.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, ne piken 8.7 dhe 8.9 :  
“8.7 Mbetjet spitalore nuk duhet të presohen apo t’u nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike, përveç rasteve kur këto janë pjesë e një procesi të posaçëm trajtimi, të miratuar nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, bazuar në ligjin nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”. Mbetjet e rrezikshme spitalore transportohen brenda 45 ditësh nga grumbullimi i tyre.

8.9 Magazinimi i mbetjeve spitalore. Mbetjet infektive nuk duhet të magazinohen për më shumë se 45 ditë para trajtimit. Në qoftë se era përbën shqetësim publik, Inspektorati Sanitar Shtetëror/Inspektorati i Mjedisit kërkon largim më të shpeshtë. Në zonën e magazinimit të kontejnerëve me mbetje mjekësore duhet të ndalohej hyrja e personave të paautorizuar. Zonat e magazinimit duhet të kenë shenja paralajmëruese në dyert hyrëse, porta ose kapakë. Në zonën e magazinimit nuk duhet të lejohet hyrja e kafshëve dhe elementeve natyrore dhe të parandalohet

krijimi i vendeve të shumimit ose burimit të ushqimit për brejtësit ose insektet. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të rrethuara.”

Nga sa me lart konstatojmë dy faza përpara trajtimit të mbetjeve, faza e parë është magazinimi dhe transportimi i tyre brenda 45 ditësh nga autoriteti kontraktor dhe faza e dytë është magazinimi dhe trajtimi i tyre pas transportimit nga operatori ekonomik i cili ka gjithashtu 45 dite në dispozicion të magazinave përpara trajtimit, ndaj nëse do të pësonte defekt apo anomali impianti i trajtimit të mbetjeve afati prej 45 ditësh është mese i mjaftueshëm për riparimin e defektit nga operatori ekonomik dhe trajtimi i mbetjeve infektive në autoklave brenda këtyre afateve.

Ndërsa për sa i përket mbetjeve që trajtohen me incenerator (kryesisht kodi 18 01 02) ato nuk mund të konsiderohen infektive sepse nuk klasifikohen si të tilla nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, ndaj magazinimi i tyre mund të jete pa limit por të ruhet në kushtet e ngrirjes (në frigorifer).

Për sa me lart mund të kërkohet disponueshmëria e ambienteve të mjaftueshme për magazinimin e mbetjeve apo për kushtet e ruajtjes së tyre por kurrsesi nuk mund të kërkohet back up për asnjërën prej mënyrave të trajtimit të mbetjeve.

Gjithashtu dhe makineria e larjes nëse do të pësonte defekte mund të ofrohet autoritetit kontraktor konteniere të rinj të përdorur deri në riparimin e pajisjeve, apo ato të dezinfektuar me pare.

Sqarojmë se studimi i tregut dhe i gjithë dokumentacioni vijues është kryer nga autoriteti kontraktor, vetëm me 1 qëllim, pengimin e konkurrencës dhe paracaktimin e subjektit fitues, sipas udhëzimeve pas dështimit për të njëjtën arsye realizimi i kësaj procedure nga organi qendror blerës.

Siç do të provojmë më poshtë, tashmë fituesi i kësaj procedure prokurimi është paracaktuar dhe zhvillimi i procedurës së hapur është thjesht fiktiv.

Këto veprime të AK-së bien ndesh me parimet dhe qëllimet e pëshkruar në nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilin parashikohet se:

Neni 2

Qëllimi

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën

Me veprimet e tij, autoriteti kontraktor, me zhvillimin e kësaj procedure prokurimi me këtë kriter të vendosur ka cenuar çdo parim dhe qëllim të vendosur nga ligjvënësi. Pse e themi këtë?!

Së pari, në fushën objekt prokurimi rezultojnë të operojnë vetëm 4 kompani, e konkretisht:

1. V.A.L.E Recycling shpk
2. Medi - Tel shpk
3. Pura-Medical shpk
4. Eco Riciklim shpk

Çuditërisht, vetëm njëra shoqëri (shoqëria e paracaktuar fituese), referuar dhe dokumentacionit shoqëruës të ankesës rezulton të ketë kapacitetin e kërkuar nga AK si më sipër, ndërsa të tre subjektet juridike nuk do të arrijnë dot kualifikimin për shkak të kriterëve të vendosura nga ana e autoritetit kontraktor për Impiant për trajtimin me sterilizim (teknologji autoklavim ose ekuivalente) - cope 1 dhe impiant back up ose zevendesues me të njëjtën metodë; Impiant për asgjësimin me incenerim - cope 1 dhe impiant back up ose zevendesues me të njëjtën metodë; Makineri për larjen e kontenerëve cope 1 dhe makineri back up ose zevendesues të tillë (vetëm në rastin kur do të perdoren konteniere të riperdorshëm);

Kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor cenojnë besueshmërinë dhe shkelin të gjitha parimet themelore të ligjit të prokurimit publik për arsytet e mëposhtme: Së pari, nëpërmjet paracaktimit të fituesit dhe vendosjes së kushtet në mënyrë që vetëm një operator ekonomik i përmbush, është shkelur parimi i rritjes së efikasitetit dhe eficensës në procedurat e prokurimit publik. Në këtë rast këto parime kanë shkuar ndesh me ligjin, thënë ndryshe efikasiteti dhe eficensa janë përdorur për të ulur konkurrencën dhe lehtësimin e procedurës për shpalljes fitues të subjektit të paracaktuar. Së dyti, nuk kemi një sigurim të fondeve publike pasi a) vetëm një operator ekonomik do të jetë në treg i cili do të paracakttojë dhe çmimet b) pas përfundimit të kësaj kontrate, me zhdukjen e konkurrencës, zhvillimi dhe përcaktimi i çmimeve do të varet tërësisht nga vullneti i këtij subjekti. c) nuk mund të kemi një mirë sigurim të fondeve publike kur shkohet drejt një produkti i cili zotërohet vetëm nga një operator ekonomik,

Së treti, me veprimet e tij, autoriteti kontraktor jo vetëm nuk po nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik, por përkundrazi po e kufizon atë vetëm drejt një subjekti të vetëm, e konkretisht shoqërisë së paracaktuar prej tyre.

Së katërti, autoriteti kontraktor nuk nxit konkurrencën mes operatorëve ekonomik, por përkundrazi vendos të zhduk çdo lloj konkurrence duke krijuar si rrjedhojë një monopol në këtë treg.

Në analizë të dispozitave ligjore të LPP-së, sqarojmë se, Autoriteti Kontraktor gjatë përcaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangi çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, e cila përbën diskriminim ndaj një ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Por në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese (award criteria), për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

AK është i detyruar të zbatojë me përpikmëri dispozitat e LPP-së në hartimin e kriterëve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike) arrijmë në përfundim se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë të hapur dhe gjithëpërfshirës të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Synimi bazë i autoritetit kontraktor është realizimi i kontratës objekt prokurimi (përfitimi) i punimeve referuar standardeve të caktuara. Në lidhje me mekanizimin për realizimin e synimit të vendosur nga autoriteti kontraktor, gjykojmë se nuk gjendet në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës.

Kriteret teknike të vendosura nëpërmjet Specifikimeve teknike duhet të ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e

prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Të gjitha këto veprime të autoritetit kontraktor jo vetëm vijnë në kundërshtim me ligjin por dhe janë veprime të cilat ligjvënësi i ka konsideruar si vepra penale, veprime për të cilat në vijim pas depozitimit të kësaj ankese do të paraqesim dhe kallëzim penal pranë Prokurisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Si veprime të dënueshme, të gjitha këto akte/veprime do të konsiderohen dhe si akte që janë absolutisht të pavlefshme.

Veprimet juridike janë absolutisht të pavlefshme kur ato vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit ose janë kryer në mashtrim të ligjit. Me dispozitë urdhëruese do të kuptojmë ato dispozita zbatimi i së cilave nuk mund të shmanget nga vullneti i palëve.

Pikërisht, lidhur me këto veprime ligjvënësi, i ka dhënë një rëndësi të duhur kur jo vetëm i ka parashikuar në ligjin material përkatës, por i ka dhënë një mbrotje më të posaçme, duke i cilësuar si vepra penale.

Në nenin 258 të Kodit Penal është parashikuar:

Neni 258

Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike

Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Referuar dispozitës së nenit 258 me shprehjen në kundërshtim me ligjin do të kuptohet çdo veprim ose mosveprim i anëtarëve të Komisioneve që ndjekin procedurat e një tenderi të përligjet juridikisht. Si qëndrime të kundërligjshme përfshihen: kur kufizohet liria e pjesëmarrësve, kur qëllimisht nuk krijon kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndaj të gjithë subjekteve të interesuara, nuk respektohet transparenca në procedurën e prokurimit etj.

Pikërisht në rastin konkret, duke kufizuar numrin e pjesëmarrësve dhe duke mos krijuar qëllimisht kushte për një konkurim të paanshëm e të hapur po konsumoni nga ana objektive dhe subjektive këtë vepër penale.

Këto vepra penale, të ushtruar nga Autoriteti Kontraktor, përveçse cilësimin të sipërpërmendur përbëjnë dhe vepër tjetër penale, e jo vetëm anëtarët e Komisioneve por dhe titullari i autoritetit kontraktor e cila me marrjen dijeni të këtyre fakteve duhet të urdhërojë ndryshimin e kriterëve të procedurës së prokurimit dhe ribërjen e saj duke marrë në konsideratë heqjen e kriterëve të cilat kanë për qëllim pengimin e konkurrencës, mirëpërdorimin e fondeve publike etj.

Sa më sipër, përfundimisht kërkojmë nga autoriteti kontraktor dhe KPP heqjen e impiantit/makinerise back up për secilën nga makineritë/impantet ose zëvendësues me të njëjtën metodë.

SHTOJCA NR. 8

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteret e Veçanta të Kualifikimit



“2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë kontratë të lidhur me një subjekt të lejuar nga AKM për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi, e cila duhet të jetë aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave. Subjekti në fjalë duhet të jetë i autorizuar në Lejen Mjedisore përkatëse për të pranuar produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologjinë pa djegie pjesë e grupit të kodeve 19 03 të katalogut shqiptar të mbetjeve dhe produktin final që del nga procesi i trajtimit me teknologji me djegie (incenerimit) pjesë e grupit të kodeve 19 03 të katalogut shqiptar të mbetjeve. Për përmbushjen e këtij kriteri ofertuesit duhet të paraqesin:

? Kontratë /akt marrëveshje me subjektin e licensuar për depozitimin e produktit final që del nga asgjësimi/trajtimi të jete aktive në momentin e dorëzimit të ofertave si dhe një deklaratë për vazhdimësinë e kësaj marrëveshje për mbulimin e plote të kontratës së prokurimit.”

V.A.L.E Recycling vlerëson se kriteri i sipërcituar, në pjesën “një deklaratë për vazhdimësinë e kësaj marrëveshje për mbulimin e plote të kontratës së prokurimit” nuk është hartuar në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik duke kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, dhe cenon marrëdhëniet e lira ekonomike ndërmjet shoqërive, si dhe kufizon në mënyrë artificiale konkurrencën.

Në këtë kuptim gjykojmë se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke hequr kërkesën për të paraqitur ‘deklaratën për vazhdimësinë e kësaj marrëveshje për mbulimin e plote të kontratës së prokurimit’, me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Theksojmë se është detyrim i operatorëve ekonomikë që në rast të shpalljes fitues t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtin cilësi të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, sqarojmë se në bazë të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Sjellim në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të LPP-së, si më sipër cituar. Është e mjaftueshme disponimi i një kontrate, e cila të jete aktive dhe e lidhur me një subjekt(landfill) të autorizuar për përmbushjen e këtij kriteri.

Sa më sipër, kërkojmë nga autoriteti kontraktor të ndryshojë kriterin 2.3.6 duke hequr shprehjen “si dhe një deklaratë për vazhdimësinë e kësaj marrëveshje për mbulimin e plote të kontratës së prokurimit”.

## 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkonti)*

Ekspert mjedisor per trajtimin e mbetjeve spitalore.

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

JO

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

JO

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

recycling.vale@gmail.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Elvis Miri